

Enton SADIKU

Enton Sadiku është Drejtor i Drejtorisë së Sigurisë së Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK). Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, ka kryer hartimin e politikave për sigurimin e informacionit të klasifikuar; mbikqyrjen dhe drejtimin e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit të klasifikuar të NATO dhe BE; drejtimin dhe ndjekjen e procesit të akreditimit të sigurisë për sistemet e komunikimit në të cilat trajtohet informacion i klasifikuar: përfaqësimin e AKSIK në marrëdhëniet me Zyrën e Sigurisë së NATO dhe në Komitetin e Sigurisë së NATO për çështje të ndryshme të sigurisë.

Enton Sadiku është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ai ka përfunduar studimet Postmaster mbi Sigurinë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, pranë universitetit privat, “Albanian University”, Tiranë, dhe pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Njëkohësisht është trajnuar nga Projekti i financuar nga BE për zbatimin e metodologjisë së re për hartimin dhe monitorimin e instrumentave kryesor për planifikimin dhe koordinimin e reformave të lidhura me BE, si dhe për Zvillimin e Planifikimit Strategjik të Sigurisë “Strategic Planning for Security and Development”, etj.

Enton Sadiku gëzon titullin “Avokat”, si dhe zotëron gjuhën angleze dhe italiane.